




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KOMITETI KËSHILLDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

KKEGJ. Nr.1/2023

Komiteti këshilldhënës për etikë gjyqësore (KKEGJ), në bazë të nenit 10.1, të Rregullores nr. 01/2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore, si dhe nenit 5, të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar, duke vendosur lidhur me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës të Apelit të Kosovës në Prishtinë, të datës 15 shkurt 2023, në takimin e mbajtur me datën 12.04.2023, jepë këtë:

OPINION KËSHILLDHËNËS

-Për standardet etike të zbatueshme lidhur me organizimin e punës së gjyqtarëve me qëllim të shfytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës-

I. Baza ligjore e punës së Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore

1. Komiteti Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), është themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me Rregulloren nr.01/2022, datë 21 janar 2022. Mandati dhe fushëveprimi i KKEGJ është përcaktuar me Rregulloren e sipërcituar. Sipas nenit 1.2 të Rregullores, “Ky Komitet do të ndihmoj gjyqtarët me informacione dhe këshilla rreth pyetjeve apo çështjeve etike të identifikuar për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”. Sipas nenit 1.3 të kësaj rregullore “Komiteti do të shërbej si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si ti trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale

për Gjyqtarët“. Rregullorja në fjalë në nenin 6.1 ka përcaktuar” 1. Kryetarët dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve të gjykatave, mund të drejtohen Komitetit me kërkesa për dhënie të opinioneve, lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë “.

II. Çështja etike e parashtruar

2. Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, me datë 15 shkurt 2023, i është drejtuar me kërkesë KKEGJ, duke kërkuar nga Komiteti që në kuadër të autorizimeve të tij, të jap një opinion këshilldhënës, lidhur me organizimin e punës së gjyqtarëve me qëllim të shfytëzimit të plotë dhe efikase të orarit të punës.

3. Në këtë kërkesë, Kryetari i Gjykatës së Apelit, ndër të tjera ka potencuar se në bazë të nenit 2.1 të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar, parashihet se gjyqtari me sjelljet e tij në gjykatë ruan dhe avanson besimin e publikut dhe të palëve në paanshmëri të tij dhe të gjyqësorit në përgjithësi. Tutje në këtë kërkesë ai i referohet edhe nenit 4, të këtij Kodi, në të cilin ceket se gjyqtari duhet të sillet në mënyrë të ndershme, të dinjitetshme dhe se duhet të jetë gjatë tërë kohës në harmoni me karakterin e lartë moral, i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit të gjyqësorit. Kryetari i Gjykatës së Apelit në këtë kërkesë i referohet edhe nenit 5, të këtij Kodi, në të cilin është paraparë se gjyqtari në Republikën e Kosovës është i detyruar që të organizoi punën e tij me qëllim të shfytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës.

4. Tutje në kërkesë Kryetari i Gjykatës së Apelit thekson se duke marrë për bazë këto dispozita të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar dhe qëllimin që synon ta arrij ky Kod, si dhe marrë për bazë edhe *“realitetin e prezencës në punë të gjyqtarëve nëpër Gjykatat e Republikës së Kosovës”*, duke qenë se nuk ekzistojnë rregulla specifike për orarin e punës të gjyqtarëve, por në mënyrë analoge zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit e punës, është e nevojshme që nga Komiteti të trajtohet kjo çështje. Si rrjedhojë, për sqarimin e kësaj çështje ka mbështetje edhe nga të gjithë Kryetarët e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga KKEGJ, që për të ardhmen, për të gjithë gjyqtarët të japë një opinion këshilldhënës, lidhur me organizimin e punës me qëllim të shfytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës, përkatësisht prezencës së të gjithë gjyqtarëve të Republikës së Kosovës në vendet e tyre të punës, brenda orarit të punës.

5. Si rrjedhojë, KKEGJ, pas shqyrtimit të kërkesës së cekur më lartë, i ka rezultuar se në bazë të nenit 1.2 të Rregullores nr.01/2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), ky i fundit ka mandat të japë informacione dhe këshilla për çështjet etike, vetëm për gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave të të gjitha niveleve të gjykatave. Në këtë rast, meqenëse kërkesa është parashtruar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, që është edhe autoritet kompetent për të kërkuar nga KKEGJ opinion këshilldhënës për çështjen lëndore, atëherë kjo kërkesë i plotëson kriteret e parapara me rregullore për tu marr në shqyrtim.

III. Legjislacioni i zbatueshëm vendor

6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave], ka përcaktuar se: "Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur". Ndërsa neni 102 paragrafi 3 përcakton se: "Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit". Në paragrafin 4 parashihet se: "Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm". Neni 108 paragrafi 5, përcakton se: "Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin jurisdiksion...".

7. Ligji për Gjykatat i Republikës së Kosovës Nr. 03/L-199, në nenin 7.5 ka paraparë që, "Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve".

8. Ligji Nr.06/L-057, Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në nenin 5 paragrafi 2 nënpika 2.7, ka paraparë si shkelje disiplinore të gjyqtarit, nëse "2.7 në vazhdimësi nuk kryen detyra zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj".

9. Me rregulloren mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave, përkatësisht nenin 4, përcaktohet se: "Kryetari i gjykatës drejton dhe mbikëqyrë veprimtarinë, organizimin dhe aktivitetet e administratës gjyqësore të gjykatës në baza ditore në harmoni me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme...".

10. Kodi i Etikës Profesionale të gjyqtarëve, i miratuar nga KGJK-ja me datë 17 gusht 2016, kërkon nga gjyqtarët që përveç respektimit dhe zbatimit të parimeve të tjera siç janë pavarësia, paanësia, integriteti etj, të zbatojnë me rigorizitet edhe parimin e profesionalizmit dhe përgjegjësisë në punë¹. Në këtë drejtim, neni 5, i Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar ka paraparë që: "Gjyqtari mban nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe efikase". Në nenin 5.1. të këtij Kodi parashihet se: "Funksioni gjyqtarit ka prioritet kundrejt të gjitha aktiviteteve tjera të gjyqtarit". Në paragrafin 5.2 Kodi ka paraparë që: "Gjyqtari është i detyruar që të organizoj punën brenda orarit të punës me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës". Në paragrafin 5.3 parashihet se: "Gjyqtari avancon njohuritë e tij në mënyrë të vazhdueshme, aftësitë dhe cilësitë personale me qëllim të ushtrimit adekuat të funksionit të tij". Paragrafi 5.4 parasheh: "Gjyqtari percjell praktiken relevante në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare, që nënkupton konventat ndërkombëtare dhe instrumentet tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut". Paragrafi 5.5

¹ Neni 5 i Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar.

parashihet: “Gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase dhe të ligjshme”. Ndërsa paragrafi 5.6 i Kodit përcakton se: “Gjyqtari ushtron funksionin e tij me durim, me dinjitet dhe korrektesi, si ndaj palëve në procedurë, po ashtu ndaj personave tjerë në të cilët ka kontakt profesional dhe një sjellje e tillë kërkohet prej përfaqesuesve ligjor, personelit gjyqësor dhe të tjerëve në mbikëqyrjen e tij”.

IV. Standardet ndërkombëtare të zbatueshme

11. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDNJ), e zbatuar drejtëpërdrejtë në Kosovë përmes nenit 22, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 6, përcakton se “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”. Sipas nenit 13 të KEDNJ, është përcaktuar që “Çdo njeri të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar (...)”.

12. Në bazë të Rekomandimit të Këshillit të Evropës Nr.R(94)12, të Komisionit të Ministrave të Shteteve Antare për përgjegjësinë, efikasitetin dhe rolin e gjykatësve, parimi V-Përgjegjësitë gjyqësore, përcaktohet se: “Gjykatësit kanë detyrë dhe duhet të kenë fuqinë që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre gjyqësore për të siguruar që ligji të aplikohet në mënyrë të përshtatshme dhe që rastet të trajtohen në mënyrë korrekte, efikase dhe me shpejtësi të duhur”.

13. Në bazë të Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e gjyqësorit të miratuara me Rezolutën nr. 40/32, të 29 nëntorit të vitit 1985, dhe Rezolutën nr.40/146, të 13 dhjetorit të vitit 1985 në Milano të Italisë, është përcaktuar që, “6. Parimi i pavarësisë së drejtësisë ngërthen dhe kërkon që gjyqësia të siguroj zbatimin e procedurave në mënyrë korrekte dhe të respektohen të drejtat e palëve”. Në pikën 8, të Deklaratës së Parimeve të Pavarësisë së Gjyqësorit e aprovuar nga Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore, e aprovuar me 14 tetor 2015, në Brijuni, Kroaci, është paraparë që: “Gjyqtarët duhet të mbështesin integritetin dhe pavarësin e gjyqësorit dhe fitojnë besimin e popullit duke shmangur sjellje të pahijshme dhe shfaqjen e sjelljes së pahishme në të gjithë veprimtarinë e tyre zyrtare dhe private”.

14. Në opinionin nr.3 të Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian, KKGJE (2002) Op.Nr.3, të datës 19 nëntor 2002 në Strasburg, ndër objektivat lidhur me sjelljen e gjyqtarëve në zbatimin e funksioneve gjyqësore është paraparë që, “26. Gjithashtu gjyqtarët duhet të përmbushin funksionet e tyre me kujdes dhe me shpejtësi të arsyeshme...”. Në këtë opinion në pikën e njëjtë parashihet, “...Gjithashtu gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm ndaj edhe të kenë mundësi të kryejnë obligimet e tyre sipas nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për gjykim brenda kohës së arsyeshme”. Në pikën e 36, të këtij Opinioni ndër të tjera thuhet, “KKGJE mendon që rregullat e mirësjelljes profesionale duhet të kërkojnë që gjyqtarët të largohen nga ndonjë aktivitet që mund të komprometoj dinjitetin e zyrës së tyre...”, dhe po ashtu në këtë pikë thuhet, “... Megjithatë është e rëndësishme që gjyqtarët të vazhdojnë të përkushtojnë shumicën e kohës rolit të tyre si

gjqtar...". Mendimi i KKGJE i dhënë në pikën 50. ii) të këtij dokumenti është se ‘‘ii) Gjyqtarët duhet të sillen me integritet në zyrë dhe në jetët e tyre private’. Ndërsa në pikën xi) mendimi i KKGJE është se: *“gjyqtarët duhet të ndajnë kohën më të madhe funksioneve gjyqësore duke përfshirë aktivitetet e ndërlidhura”.*

15. Këshilltari për Etikën i Këshillit të lartë Gjyqësor të Shqipërisë në Opinionin që ndërlidhet me temën e përdorimit të mediave sociale nga gjyqtarët, ndër të tjera ka shprehur këtë mendim etik për gjyqtarët, *“Pritëshmërit e publikut për integritetin e gjyqtarëve janë shumë të larta. Gjyqtarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për mënyrën se si sjellja e tyre mund të përceptohet nga individ të arsyeshëm dhe të informuar në komunitet. Çdo sjellje që cenon apo ul respektin në sytë e publikut për gjyqtarët/gjyqësorin, duhet shmangur nga gjyqtarët”.*

16. Nisur nga rëndësia e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe standardeve të kësaj gjykate në rendin juridik të Kosovës, në kuptim të çështjes së trajtuar, është e rëndësishme të theksohen edhe disa vendime gjyqësore nga jurisprudenca e GjEDNJ-it . Në këtë drejtim, neni 6, i KEDNJ-it kërkon që proceset të zhvillohen brenda “një afati të arsyeshëm”. Në kërkesën që gjykimi i çështjeve të bëhet brenda “një afati të arsyeshëm”, GjEDNJ në rastin “H kundër Francës” vë theksin tek rëndësia e administrimit të drejtësisë pa vonesa, ndërsa e kundërta e së cilës mund të kërcënoj efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj² . Si rrjedhojë e garantimit të së drejtës së qytetarëve për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, GjEDNJ në rastin Stogmuller kundër Austrisë, ndër të tjera ka përcaktuar se e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, garanton dhe mbron të gjitha palët në proces gjyqësor nga vonesat e gjata procedurale³. Ndërsa, në rastin “Mikulic kundër Kroacisë”, theksohet se *“Shtetet Kontraktuese duhet të organizojnë sistemet e tyre juridike në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e secilit për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohe të arsyeshme”*⁴.

V. Të gjeturat dhe rekomandimet

17. Fillimisht KKEGJ vlerëson se çështja lëndore e kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, është çështje ekskluzivisht etike, e cila në vetvete mund të ngërthen edhe elemente ligjore, pasi që orari i punës rregullohet me nenin 20, të Ligjit të punës, i cili është i aplikueshm edhe për sistemin gjyqësor. Përveç kësaj kjo çështje ndërlidhet edhe me *“situatat apo sjelljet e ardhshme”* etike, e që vlerësohet e nevojshme të sqarohet përmes këtij opinion këshilldhënës, nëse mos shfytëzimi i plotë dhe efikas i orarit të punës brenda zyrës së gjyqtarit, paraqet shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë. Marr për bazë këtu edhe gjendjen në të cilën ndodhet sistemi

² H kundër Francës, 24 Tetor 1989, para.58.

³ Stögmüller kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969, para. 5.

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Mikulic kundër Kroacisë. Aktgjykim. Strasburg. 4 shtator 2002. paragrafi 45.

gjyqësor, që kanë të bëjnë me numrin e madh të lëndëve të pakryera dhe vonesat e evidentuara në zgjidhjen e tyre.

18. Në këndvështrimin e gjithë kuadrit normativ të sipërmendur, është e qartë se gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues, duhet të respektojnë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit, solemnitetin dhe të drejtat e palëve në proces, të shmangin çdo qëndrim apo sjellje paragjyquese në raport me pjesëmarrësit në proces gjyqësor, të garantojnë në zgjidhjen e drejtë të çështjeve që i janë besuar, të jenë efikas dhe të arsyetojnë vendimet gjyqësore. Në këtë aspekt, KKEGJ vlerëson se Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtar është si një mekanizëm matës i standardit të sjelljes që duhet të kenë gjyqtarët, në vlerësim të performancës së tyre, të përgjegjshmërisë, profesionalizmit, përfshirë këtu edhe aspektin e disiplinës në punë.

19. Në anën tjetër, një ndër parimet e sanksionuara në Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar është ai i *“profesionalizmit dhe përgjegjësisë në punë”*⁵. Sipas tij, gjyqtari i kryen me kujdes dhe efikasitet detyrat e tij, në kohë, pa vonesë, ndërsa funksionet gjyqësore ushtrohen me nivelin më të lartë të aftësive profesionale. Profesionalizmi, sikundër edhe kujdesi i duhur, janë parakushte për kryerjen e detyrave gjyqësore.

20. KKEGJ në interpretim të parimeve të përcaktuara me dispoziten e nenit 5, (paragrafet 1 deri 6) të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar, vlerëson se gjyqtari, gjatë ushtrimit të funksionit duhet të trajtojë dhe gjykojë çështjet që i caktohen brenda një afati të arsyeshëm të përshtatshëm, pa cenuar kualitetin e vendimit, duke u kujdesur që të përcaktojë afate të arsyeshme për palët dhe për veten e tij. Në këtë kuptim, gjyqtari duhet të sigurojë administrim të drejtë të procesit gjyqësor dhe t'i kushtojë kujdes çdo pretendimi të bërë për shkelje të të drejtave. Në anën tjetër, veprimtaria profesionale e gjyqtarit duhet t'i kushtohet ushtrimit të funksionit dhe mirë administrimit të drejtësisë, duke mos cenuar kryerjen me përkushtim të detyrave gjyqësore dhe në mënyrë të vazhdueshme duhet të synojë arritjen e nivele të larta të aftësive profesionale. Kjo duhet të bëhet nga gjyqtarët duke ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe rritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për kryerjen e detyrave gjyqësore.

21. Eficienca gjyqësore përkufizohet si dhënie e vendimeve cilësore brenda një afati të arsyeshëm (*neni 6 i KEDNJ*). Gjyqtarët duhet t'u përgjigjen vendimeve dhe politikave të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e gjykatave, për të përmirësuar eficientën, me kusht që këto vendime apo politika të mos ndërhyjnë në asnjë mënyrë në pavarësinë gjyqësore. Eficienca duhet të lidhet sa me aspektet cilësore, aq edhe me ato sasiore. Ajo përfshin si gjyqtarin individual, ashtu edhe autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor⁶.

22. Parimi i pavarësisë nënkupton pavarësinë e secilit gjyqtar individual në ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Gjatë marrjes së vendimit gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të

⁵ Neni 5 i Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar.

⁶ Rekomandimi CM/Rec (2010)12, i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare, i miratuar në datën 17.11.2010.

paanshëm dhe në gjendje të veprojnë pa asnjë kufizim, ndikim të pavend, presion, kërcënim apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, nga çdo autoritet, duke përfshirë edhe autoritetet e brendshme të gjyqësorit. Organizimi hierarkik gjyqësor nuk duhet të dëmtojë pavarësinë individuale⁷.

23. KKEGJ vlerëson se gjatë ushtrimit të detyrave të tyre gjyqtarët duhet të jenë të vetëdijshëm për kontributin e tyre ndaj efikasitetit, profesionalizmit dhe përgjegjësisë në punë dhe duhet të përdorin çdo mjet procedural të administrimit të çështjeve të parashikuar nga ligji, si dhe të demonstrojnë aftësi të organizimit personal, përpikmëri dhe disponueshmëri gjatë orareve të planifikuara të punës në zyrë, përgatitje të përshtatshme, njoftim të mungesave të planifikuara, raportim të menjëhershëm të mungesave të paevitueshme, etj. Si rrjedhojë, gjyqtarët duhet të kenë një shkallë të lartë profesionalizmi dhe t'i nënshtrohen obligimit për kujdes, për të qenë në përputhje me kërkesat për të gjykuar në kohëzgjatje të arsyeshme, duke ia dedikuar kohën më të madhe funksioneve gjyqësore, në funksion të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë⁸.

24. Referuar legjislacionin në fuqi dhe praktikave të vendeve të tjera (*të rajonit, evropiane dhe SHBA-në*), KKEGJ vlerëson se ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, përpos faktit që nuk kufizohet me limite kohore/apo kohëzgjatje të kohës së punës, nuk lidhet domosdoshmërisht me qëndrimin në zyrë, për përmbushjen me korrektësi dhe efikasitet të detyrave të tij. Në këtë aspekt, gjyqtari gëzon pavarësi të plotë organizative gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, por gjithnjë, brenda kufizimeve që vendos Ligji për Gjykatat, Ligji Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (*edhe ligji i Punës në masën sa është i zbatueshëm për gjyqtarët*) dhe Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtar⁹. Vetëm këto të fundit vendosin kufizime të kësaj pavarësie të gjyqtarit dhe vetëm në aspektin e moscenimit të veprimtarisë gjyqësore, si dhe respektimit të të drejtave të njeriut, në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁰.

25. Sipas vlerësimit të KKEGJ, në kryerjen e funksioneve gjyqësore gjyqtarët, ndryshe nga pjesa më e madhe e kategorive të tjera të funksionarëve publik, nuk i nënshtrohen, pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që kryejnë, një paracaktimi të rreptë të orarit të punës, pasi ndër të tjera puna e gjyqtarit është dhe punë hulumtuese dhe krijuese¹¹. Funksioni gjyqësor ushtrohet në kushte pavarësie të gjyqtarit dhe për rrjedhojë, performanca e punës së tij, për më tepër, nuk mund të konsiderohet e përmbushur në kryerjen vetëm të veprimtarive të cilat janë të planifikuara në orë të paracaktuara, por përfshin edhe kryerjen e aktiviteteve profesionale, studimet, hulumtimet, arsyetimet e vendimeve gjyqësore dhe shumë veprimtari që lidhen dhe i shërbejnë detyrës, të cilat zhvillohen jashtë çdo orari të paracaktuar dhe normalisht mund të kryhen edhe jashtë zyrave gjyqësore. Një ndër detyrat e gjyqtarit është dhe hulumtimi dhe zbatimi i praktikave më të mira vendore dhe të huaja, në funksion të dhënies së drejtësisë dhe të një vendimi të arsyetuar mirë, e cila është baza që tregon dhënien e një vendimi të drejtë e të bazuar në prova

⁷ Ibid.

⁸ Vendimi Nr. 17, datë 17.01.2022, i Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.

⁹ Neni 5 i Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar.

¹⁰ Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

¹¹ Siç edhe kërkohet nga parag. 5.3 të Kodit të Etikës.

e ligj¹². Në lidhje me këtë, KGJK përmes mekanizmave ligjor siç janë vlerësimi i rregullt i performances së gjyqtarëve, normimi i punës së gjyqtarëve, disiplinimi për shkelje etike dhe të detyrave të punës, vlerëson profesionalizmin dhe përgjegjësinë në punë të gjyqtarit, në kryerjen e detyrave gjyqësore në sasinë, cilësinë dhe kohën e kërkuar, si dhe në përputhje me standardet etike të normuara me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar.

26. KKEGJ vlerëson se përkundër natyrës së funksionit të cilin e ka, gjyqtari në masën sa të jetë e mundur, i njëjti duhet të përpiqet që gjatë kryerjes së detyrave gjyqësore të jetë sa më efikas dhe profesional, duke e menaxhuar dhe shfrytëzuar maksimalisht orarin e punës, në drejtim të përfundimit të gjitha detyrimeve të cilat ndërlidhen me punën e tij. Gjyqtari duhet ti shmang sa të jetë e mundur të gjitha sjelljet që lidhen me ardhjen sistematike me vonesë në punë, me daljen sistematike brenda orarit të punës, dhe me daljen sistematike para mbarimit të orarit të punës, e të cilat për pasojë edhe do të kishin ndikim në mos kryerjen e detyrave gjyqësore në sasinë, cilësinë dhe kohën e kërkuar me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar¹³. Kjo sigurisht vlenë vetëm për rastet kur mungesa e gjyqtarit nuk ndërlidhet me arsye zyrtare dhe profesionale. Gjyqtari është një figurë e rëndësishme publike dhe është subjekt i vëzhgimit publik, prandaj ai duhet ti pranojë kufizimet që janë përcaktuar me Kodin e Etikës profesionale për gjyqtar (*nenin 5 të Kodit të Etikës*). Sjelljet e gjyqtarit brenda dhe jashtë zyrës së tij kanë ndikim në imazhin e figures së gjyqtarit, por edhe në imazhin e gjyqësorit në përgjithësi (*neni 2.1 i Kodit të Etikës*). Gjyqtarët vërehen çdo ditë nga syri opinionit publik dhe nga palët ku do që ndodhen ata, në zyrën e tij apo jashtë saj. Prandaj, gjyqtari duhet të bëjë përpjekje maksimale që gjatë orarit të punës detyrat gjyqësore ti kryejë në sasinë, cilësinë dhe kohën e kërkuar, duke respektuar standardet e përcaktuara me Kodin e Etikës.

27. Megjithatë përkundër asaj që u tha më sipër, KKEGJ konsideron se gjyqtari është i obliguar në bazë të rregullave të Kodit të Etikës profesionale për gjyqtar, që ta organizoj mirë punën në zyrën e tij, me qëllim që të shfrytëzoj në mënyrë të plotë dhe efikase orarin e tij të punës, sidomos në rastet dhe ditët kur ai ofron shërbime gjyqësore për palë, të cilët i ka ftuar në seanca gjyqësore në lëndët konkrete me të cilat ai është i ngarkuar. Ky objektiv dhe ky synim, asnjëherë nuk duhet të vëhet në dyshim dhe as të rrezikohet nga gjyqtari, pasi që të njëjtat burojnë dhe kanë mbështetje në Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar, për çka edhe ky detyrim gjithsesi duhet të përmbushet.

28. Në bazë të rrethanave të cilat janë paraqitur në kërkesën e parashtruesit dhe të atyre që në shumë raste edhe mund të përceptohen negativisht nga opinionit publik, apo nga shoqëria civile, mund të ndodhë që gjyqtarët jo çdo herë e shfrytëzojnë në mënyrë të plotë, me efikasitet dhe përgjegjësi orarin e rregullt të punës në zyrën e tij. Sjelljet e tilla të përsëritura në baza ditore sigurisht ndikojnë negativisht në punën efikase të gjyqtarit, duke e dëmtuar reputacionin dhe figurën e gjyqtarit në veçanti, por edhe imazhin e gjyqësorit në përgjithësi. Prandaj veprimet e tilla, jashtë rasteve zyrtare apo profesionale, në mënyrë sistematike nga gjyqtari, e të cilat ndikojnë

¹² Siç edhe kërkohej me nenin 5 parag. 4 të Kodit të Etikës.

¹³ Neni 6 i KEDNJ-ës.

drejtëpërdrejtë në kryerjen e detyrave gjyqësore në mënyrë efikase, sasiore dhe cilësore dhe brenda një kohe të arsyeshme, konsiderohen se janë veprime jo në pajtim me nenin 5, paragrafi 5.2 të Kodit të Etikës profesionale për gjyqtar.

29. KKEGJ, konsideron se kryetari i Gjykatës përkatëse dhe gjyqtari mbikqyrës në degën e saj, kanë përgjegjësi menaxheriale dhe janë autoritet ligjor që ta përcjellin dhe mbikqyrin edhe në këtë drejtim, punën e gjyqtarit në gjykatën ku ai shërben¹⁴. Megjithatë, duke u nisur nga mënyra e vetëorganizimit dhe ushtrimit të detyrave gjyqësore nga ana e gjyqtarëve, në rastin konkret, analiza që kryetari i Gjykatës do duhej t'i bënte secilit rast, qëndron në vlerësimin nëse gjyqtari me sjelljen e tij (*mungesën e prezencës së tij/saj në gjykatë*) ka balancuar në mënyrë të drejtë nga njëra anë, pavarësinë organizative në funksion të rritjes së efikasitetit në punë të tij/saj dhe nga ana tjetër, kujdesin e duhur në ruajtjen dhe moscënimin e veprimtarisë gjyqësore të të gjithë gjyqtarëve të gjykatës ku ai/a jo ushtron funksionin. Në rastin kur kjo balancë nuk do të ruhej, pra në rast se gjyqtari me mungesën e tij/saj do të cenonte në ndonjë mënyrë veprimtarinë e tij/saj gjyqësore apo të gjyqtarëve të tjerë, mungesa që do të sillte këtë pasojë, do të konsiderohej si mungesë në detyrë e tij/saj, me përjashtim të rasteve kur ai/a jo do të ishte e justifikuar me shkaqe objektive dhe të arsyeshme¹⁵.

30. Në lidhje me këtë, KKEGJ vlerëson se marrëdhënia midis kryetarit e gjyqtarit nuk është një marrëdhënie hierarkie e varësie. Kjo për faktin se ajo duhet të karakterizohet nga ndërtimi i një ambienti pune në gjykatë mbi bazën e mirëkuptimit e bashkëpunimit, duke ruajtur pavarësinë në ushtrimin e funksioneve gjyqësore, e cila i shërben dhënies së drejtësisë dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Andaj, edhe ushtrimi i funksionit drejtues në gjykatë duhet të bëhet në shërbim të mirëadministrimit të drejtësisë, kurse edhe mbikëqyrja e disiplinës në punë nga ana e Kryetarit të Gjykatës duhet t'i përgjigjet këtij misioni. Nga ana tjetër, gjyqtari duhet të respektojë autoritetin e kompetencave që ligji i atribuon Kryetarit, jo vetëm si mbikëqyrës i etikës, solemnitetit dhe disiplinës në punë, por dhe si autoriteti përgjegjës që kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor, me qëllim garantimin e ushtrimit të funksioneve gjyqësore nga gjyqtarët e gjykatës të cilën ai drejton, duke mos cenuar në asnjë moment funksionin e dhënies së një drejtësie sa më cilësore dhe brenda një afati të arsyeshëm, në shërbim të publikut.

VI. Konkluzionet përfundimtare

31. KKEGJ, vlerëson se gjyqtarët e të gjitha gjykatave dhe të gjitha niveleve të Republikës së Kosovës, duhet që në masën sa të jetë e mundur të bëjnë përpjekje maksimale të organizojnë punët në Zyrët e tyre, me qëllim të shfrytëzimit sa më të plotë dhe efikas të orarit të punës, si një detyrim etik i gjyqtarit, i përcaktuar me nenin 5, paragrafi 5.2, 5.3 dhe 5.4 të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar.

¹⁴ Ligji për Gjykatat, Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore, Rregullorja për Veprimtarinë e Brendshme të gjykatave.

¹⁵ Vendimi Nr. 17, datë 17.01.2022, i Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.

32. KKEGJ vlerëson se ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, përpos faktit që nuk kufizohet me limite kohore/apo kohëzgjatje të kohës së punës, nuk lidhet domosdoshmërisht me qëndrimin në zyrë, për përmbushjen me korrektësi dhe efikasitet të detyrave të tij. Në këtë aspekt, gjyqtari gëzon pavarësi të plotë organizative gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, por gjithnjë, brenda kufizimeve që vendos Ligji për Gjykatat, Ligji 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligji i Punës në masën sa është i zbatueshëm për gjyqtarët dhe Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtar.

33. Sipas vlerësimit të KKEGJ, në kryerjen e funksioneve gjyqësore gjyqtarët, ndryshe nga pjesa më e madhe e kategorive të tjera të funksionarëve publik, nuk i nënshtrohen, pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që kryejnë, një paracaktimi të rreptë të orarit të punës, pasi ndër të tjera puna e gjyqtarit është dhe punë hulumtuese dhe krijuese. Këtu ndër të tjera përfshihet edhe kryerja e aktiviteteve profesionale, studimet, hulumtimet, arsyetimet e vendimeve gjyqësore dhe shumë veprimtari që lidhen dhe i shërbejnë detyrës, të cilat zhvillohen jashtë çdo orari të paracaktuar dhe normalisht mund të kryhen edhe jashtë zyrave gjyqësore.

34. Gjyqtari duhet ti shmang sa të jetë e mundur të gjitha sjelljet që lidhen me ardhjen sistematike me vonesë në punë, me daljen sistematike brenda orarit të punës dhe me daljen sistematike para mbarimit të orarit të punës, e të cilat për pasojë edhe do të kishin ndikim të drejtëpërdrejtë në mos kryerjen e detyrave gjyqësore në sasinë, cilësinë dhe kohën e kërkuar me legjislacionin vendor dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

35. Në të kundërtën, veprimet e tilla të gjyqtarit, të cilat pas analizës së kryer nga Kryetari i gjykatës siç është përcaktuar në pikën 29 të këtij opinionimi këshilldhënës, rezultojnë me ndikim të drejtëpërdrejtë në mos kryerjen e detyrave gjyqësore në mënyrë efikase, sasiore, cilësore dhe brenda një kohe të arsyeshme, konsiderohen se janë veprime jo në pajtim me nenin 5, paragrafët 5.2 dhe 5.5 të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar dhe mund të përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore.

**Kryetari i Komitetit,
Muhamet Rexha**

